



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2968/ 4 Prot

Datë 18.11.2025

V E N D I M

Nr. 1697/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit së “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64836-10-14-2025, me objekt: Blerje Paisje Kompjuterike (Pc, Ups, Printer, etj), me fond limit në vlerën: 2,970,529 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK
Adresa: Rr.Fortuzi Nr. 66/1, Nj.Adm 10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Divjakë
Adresa: Lagjia nr.2, Sheshi “Santa Barbara”.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.10.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64836-10-14-2025, me objekt: Blerje Paisje Kompjuterike (Pc, Ups, Printer, etj), me fond limit në vlerën: 2,970,529 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5988, datë 21.10.2025 dhe me Nr. 2968/2025 Prot., date 28.10.2025 e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën ardhur në shërbim postar nr. 10678/6 Prot., datë 27.10.2025 protokolluar me tonën me nr. 2968/1 prot., datë 30.10.2025, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me Vendimin e KSHA-së ka vendosur mospranim të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacionit të dosjes administrative,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” ShPK i cili argumenton se:

[..]Ne shtojcën 8 Kriteri 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet objekt kontrate, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Ne kete procedure prokurimi do te prokurohen mallrat si me poshte:

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Kompjuter Desktop 1	Copë	10
2	Laptop Advanced	Copë	1
3	UPS 1000 VA	Copë	10
4	Fotokopje Multifunction B&W MFP Basic	Copë	1
5	Fotokopje Multifunction Color MFP Basic	Copë	1
6	Fotokopje Multifunction B&W Copy Machine A3	Copë	2
7	Fotokopje Multifunction Color Copy Machine A4	Copë	6
8	Printer B&W Advanced	Copë	1

Vleresojme si te argumentuar dhe ne proporcion me madhesine e kontrates, kerkesen per autorizim prodhuesi per artikujt nr 1,2,6,7,9 pasi keto artikuj perbejne rreth 95% te fondit limit.

*Ndërkohe kërkesa per autorizim prodhuesi edhe për artikujt e tjere që **jane 1 cope (artikujt nr. 4,5,8) apo per artikullin UPS I cili pavaresisht se eshte 10 cope** nuk perben as 3% te fondit limit, nuk eshte proporcionale , nuk mbeshtetet ne parashikimet e LPP dhe VKM per RPP.*

Përveç mungesës së proporcionalitetit, kërkesa për artikuj që gjenden lehtësisht në treg, siç është UPS 1000VA, do të kufizonte ndjeshëm konkurrencën, dhe do të kufizonte pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, pasi do të duheshin autorizimi prodhuesi edhe për keto produkte që gjenden lehtësisht në treg apo që nuk përbejnë as 3% të fondit limit

Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e kerkeses se mesiperme ne:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet 1,2,6,7,9, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

III.1.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST dokumentet e tenderit,

Shtojca 7. (Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

PREVENTIV

Nr	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Kompjuter Desktop 1	Copë	10
2	Laptop Advanced	Copë	1
3	UPS 1000 VA	Copë	10
4	Fotokopje Multifunction B&W MFP Basic	Copë	1
5	Fotokopje Multifunction Color MFP Basic	Copë	1
6	Fotokopje Multifunction B&W Copy Machine A3	Copë	2
7	Fotokopje Multifunction Color Copy Machine A4	Copë	6
8	Printer B&W Advanced	Copë	1
9	Printer All In One B&W	Copë	4

Shtojca 8, Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, **2.3** Kapaciteti teknik:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet objekt kontrate, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mallrat që oferton të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit (shih specifikimet teknike), të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në katalog duhet të markohet secili nga artikujt e ofertuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

III.1.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: “1.Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1 Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e

asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim llojin e procedurës së prokurimit, me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit, fondin limit dhe sasite e mallrave.

Është detyrë e njësive përkatëse të mirëargumentojnë kriteret për kualifikim me qëllim që të jenë sa më të plota dhe të sakta, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë besueshmërinë në eksperiencat e tyre, seriozitetin në aktivitetin që kryejnë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) *në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe* (ii) *jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.*

Referuar objektit të prokurimit, dokumenteve të tenderit si edhe kriterëve për kualifikim, **pika 2.3.3 dhe 2.3.4** Autoriteti kontraktor ka vendosur dy kriterë kualifikuesë me qëllimin për t'u siguruar dhe verifikuar cilësinë, origjinalitetin dhe parametrat e pajisjeve objekt prokurimi.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik i cili ndër të tjera argumenton: [...] *Vlerësojmë që AK të kërkojë: autorizim prodhuesi për artikujt nr 1,2,6,7,9 pasi keto artikuj perbejne rreth 95% te fondit limit. Ndërkohe kërkesa për autorizim prodhuesi edhe për artikujt e tjere që **jane 1 cope (artikujt nr. 4,5,8) apo për artikullin UPS I cili pavaresisht se eshte 10 cope nuk perben as 3% te fondit limit, nuk eshte proporcionale, nuk mbeshtetet ne parashikimet e LPP dhe VKM per RPP.*** [...] Komisioni vëren se Autoriteti kontraktor ka kërkuar Autorizim prodhuesi për të gjithë artikujt duke u bërë objekt ankimi nga operatorët ekonomikë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përgjigje të testit të proporcionalitetit, Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë që Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë autorizimin e prodhuesit **për pajisjet e kërkuara në numër të madh apo me rëndësi të veçantë**, ndërsa për artikujt e tjerë AK ka mundësi verifikimi nëpërmjet kërkesës në kriterin **2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mallrat [...]**

Autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë qartë përse është e nevojshme paraqitja e autorizimit të prodhuesit për të gjithë artikujt objekt prokurimi ndaj dhe duhet të modifikojë kriterin **2.3.3.**

Në përfundim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se **kriteri 2.3.3**, në lidhje me paraqitjen e Autorizimin e Prodhuesit ose të distributorit të autorizuar **për pajisjet e kërkuara**, nuk është në proporcion me sasinë e mallrave dhe fondin limit dhe se ankesa e operatorit ekonomik për pikën e parë është e drejtë dhe e mirëargumentuar.

Autoriteti të modifikojë kriterin objekt ankimi mbi kërkesën për paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose të Distributorit të autorizuar vetëm për artikujt në numër të madh apo me rëndësi të veçantë.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK,: [..]Ne shtojcën 8 veme re që kriteret **2.3.4** dhe **2.3.7** janë dublikim i njeri tjetrit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mallrat e ofertuar janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mallrat që oferton të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit (shih specifikimet teknike), të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në katalog duhet të markohet secili nga artikujt e ofertuar.

Nese OE deklaron se mallrat e ofertuar jane ne perputhje me specifikimet teknike, eshte e tepert qe te paraqesi edhe katalogje per cdo produkt, pasi praktikisht keto 2 kerkesa kane te njejtin qellim. Per me teper, AK ne momentin e marrjes ne dorezim te mallit do te duhet te krahasoje paisjet e dorezuara me specifikimet teknike. Analizimi i paisjeve 2 here, nje here ne fazen e vleresimit te ofertave, dhe nje here ne fazen e levrimit te mallrave nuk sjell asnje vlere te shtuar ne procesin e prokurimit, pervec se komplikon fazen e vleresimit te ofertave.Te dyja keto kerkesa kane te njejten vlere ne fazen e shqyrtimit te ofertave, dhe per sa kohe kerkesa vetem per deklaraten e OE thjeshteson manaxhimin e fazes se vleresimit te ofertave, (gjithsesi AK do te verifikoje perputhshmerine e specifikimeve teknike ne fazen e marrjes ne dorezim) vleresojme si te mjaftueshme kerkesen per deklarate.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses 2.3.4 ne shtojcën 8.

III.2.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Shtojcën 8, 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mallrat që oferton të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit (shih specifikimet teknike), të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në katalog duhet të markohet secili nga artikujt e ofertuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mallrat e ofertuar janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/Enti Kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se Operatori Ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se të gjitha mallrat e ofertuara, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST

III.2.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Neni 3 Parime të përgjithshme i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.4. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në

cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “I Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.6. Neni 40/3/6, i VKM-së nr.285, datw 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të

përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ajo e dukshme, apo jo, të cilat kanë të njëjtin efekt. Autoriteti kontraktor në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që ato ti shërbejnë dhe të jenë në funksion të qëllimit të objektit të prokurimit e jo të dalin përtej saj, çfarë është më me rëndësi për realizimin me sukses të kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar pretendimeve në lidhje me kriteret kualifikuese 2.3.4 dhe 2.3.7. gjykon të drejtë vendosjen e **kriterit 2.3.4**, si një kriter i rëndësishëm dhe ligjor i cili i shërben autoritetit kontraktor për një vlerësim sa më të saktë të përputhjes së parametrave të pajisjeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë me parametrat e Shtojcës 6, Specifikimet teknike (gjithashtu argumentuar më sipër në pikën III.1.3 mbi rëndësinë e kriterit 2.3.4).

Përsa i përket pretendimeve mbi kriterin 2.3.7 “si i dubluar me kriterin 2.3.4”, Komisioni gjykon, se ky kriter nuk cënon konkurrencën apo vështirëson operatorët, pasi është një deklaratë dhe nuk mund të zëvendësojë kursesi kriterin kualifikues 2.3.4.

Në përfundim të argumenteve dhe në analizë të kriterëve për kualifikim Komisioni vlerëson të rëndësishëm vendosjen e kriterit objekt ankimi 2.3.4, *mbi paraqitje të katalogëve dhe mban të*

njejtin qëndrim si në pikën sipërcituar, mbi rëndësinë e tij për një vlerësimin të drejtë të cilësisë së mallrave objekt prokurimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Blueprint Technologies” ShPK i cili argumenton se: [...] Ne specifikimet teknike për artikullin nr.2 Laptop Advanced, është shtuar një element në dukje i vogël por që në thelb prish gjithë konfigurimin e paisjes laptop Advanced. Për këtë paisje është shtuar kërkesa për **Modul për Kartë SIM të Integruar (4G)**;

Karta SIM 4G e integruar është specifikim teknik karakteristik i paisjeve të cilat kanë në fokus mobilitetin (levizshmërinë dhe sigurimin e internetit ku nuk ka rrjet internet), dhe nuk është karakteristike e laptopeve workstation. Shtimi i këtij elementi i cili nuk është parashikuar nga AKSHI, kufizon ofertat vetëm në një markë që ka prodhuar një laptop me kartë sim të integruar (dhe që nuk e prodhon më) konkretisht markën Lenovo. AK ka argumentuar këtë ndryshim që i ka bërë Specifikimeve teknike të AKSHI-t me Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT Nr.2483/135 Prot., datë 17.07.2024 dhe BASHKISË DIVJAKË Nr.9136 Prot., datë 16.12.2024, ANEKSI 1, konkretisht Modul për Kartë SIM të Integruar (4G)

Nëse vëmë re specifikimet e reja të AKSHI-t, dallohet ndryshimi që këto të fundit kanë bërë për DVD+/-RW. Duke qenë se pothuajse të gjithë kompjuteret e rinj që prodhohen, nuk kanë të integruar DVD+/-R pasi kjo e fundit përdoret gjithnjë e më pak, AKSHI ka shtuar: mund të përdoret dhe DVD+/-RW e jashtme, jo domosdoshmërisht e të njëjtës markë me kompjuterin.

Në të njëjten llogjikë, duke qenë se moduli kartës SIM nuk është një element që përdoret në masë, dhe mund të gjendet shumë lehtësisht si një paisje e jashtme,

AK duhet të ndryshojë kërkesën për modul të kartës SIM,

nga e integruar, në mund të përdoret dhe modul SIM 4G e jashtme, jo domosdoshmërisht e të njëjtës markë me kompjuterin.

Për sa më sipër kërkojmë ndryshimin e specifikimeve teknike për artikullin **Laptop Advanced** në lidhje me këtë modul si më poshtë:

Modul për Kartë SIM të Integruar (4G) mund të përdoret dhe modul SIM 4G e jashtme, jo domosdoshmërisht e të njëjtës markë me kompjuterin

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Shtojcën 6, Specifikimet Teknike,

2. LAPTOP ADVANCED

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:	12200 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	≥ 500 GB SSD
“Graphics”:	Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory

Ekrani “Display”:	15.6" FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 60 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 (1) DP/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	<u>Modul për Kartë SIM të Integruar (4G); *</u> 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1;
“Sound”:	Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 11 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuksi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periodha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

*** Shënim:** Në Rubrikën Rrjeti “Networking” të Specifikimeve Teknike për LAPTOP ADVANCED është shtuar si kriter minimal i domosdoshëm edhe “Modul për Kartë SIM të Integruar (4G), në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT Nr.2483/135 Prot., datë 17.07.2024 dhe BASHKISË DIVJAKË Nr.9136 Prot., datë 16.12.2024, ANEKSI 1, konkretisht “Modul për Kartë SIM të Integruar (4G)”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III.3.2. Neni 36, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një

gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së Lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se: *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

III.3.4 Komisioni nga shqyrtimi i DST-së së procedurës objekt gjykimi konstaton, se Autoriteti Kontraktor, në hartimin e Shtojcës 6, në tërësi të saj, i është referuar Standardeve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, publikuar Janar 2025, *(i vlefshëm për periudhën 1 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025).*

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik, mbi opsionin e vendosjes së [...] *Modul për Kartë SIM të Integruar (4G) mund të përdoret dhe modul SIM 4G e jashtme, jo domosdoshmërisht e të njëjtës markë me kompjuterin [...]*, Komisioni, nga shqyrtimi i Specifikimeve Teknike vëren, se:

Autoriteti Kontraktor në Shtocën 6, Specifikimet Teknike, për artikullin 2. LAPTOP ADVANCED ka vendosur tek parametri **Rrjeti “Networking”**: **Modul për Kartë SIM të Integruar (4G); *** dhe në fund të tabelës së Parametrave, ka argumentuar vendosjen e Modul për Kartë SIM të Integruar (4G), bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT Nr.2483/135 Prot., datë 17.07.2024 dhe BASHKISË DIVJAKË Nr.9136 Prot., datë 16.12.2024, ANEKSI 1, konkretisht “Modul për Kartë SIM të Integruar (4G)”.

Gjithashtu Komisioni vëren, se AK nuk ka përcaktuar që ky modul të ketë të njëjtën markë me Kompjuterin, siç pretendon ankimuesi, duke mos kufizuar ofertimin në tërësi të pajisjes drejt një marke.

Referuar ankesës, Komisioni gjykon se operatori ekonomik nuk ka argumentuar qartë se si specifikimet teknike e konkretisht pajisja objekt ankimi, ngushton konkurrencën apo orienton drejt markave të paracaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Komisioni në analizë të fakteve gjykon se Autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e Modul për Kartë SIM të Integruar (4G) në funksion të artikullit objekt ankim, në shërbim të punës së tij e lidhur me bashkëpunimin ndërinstitutional.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institutionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-64836-10-14-2025, me objekt: Blerje Paisje Kompjuterike (Pc, Ups, Printer, etj), me fond limit në vlerën: 2,970,529 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera me publikimin e shtojcës në zbatim të Vendimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” ShPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

